



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:300561

Datë: 24.06.2024

Numri i dokumentit: 05852574

K.DH.SH.II.nr.981/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Wurth Kosova”, Shpk me selinë fshatin Llapnasellë, Magjistratja Prishtinë-Ferizaj fshati Banull- Lipjan ndaj debitorit Dekoral Group SHPK NUI 810162579 me adrese Gurakovc, Burim Istog te cilin e përfaqëson Besim Osmani avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, KPPP.nr.2241/23 të datës 29.01.2024, me datën 24.06.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Dekoral Group SHPK NUI 810162579 me adrese Gurakovc, Burim Istog, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, KPPP.nr.2241/23 të datës 29.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, me aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.477/23, të datës 09.12.2023, të Përmbaruesit Privat. Mbetet ne fuqi Urdhri përmbarimor .nr.477/23, të datës 09.12.2023.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, aplikim te gabuar te se drejtës materiale, dhe shkelje te dispozitave ligjore, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar, te ndryshohet aktvendimin e shkalles se parë dhe te shfuqizohet urdhër Përmbarimor, obligohet kreditori qe debitor ti paguaj shpenzimet e procedurës ne shume 104 euro për përpilim te prapësimit dhe për ankesë 208€, si dhe te përfundohet procedura përmbarimore.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit me, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave te përshkruar ne urdhrin përbarimor P.nr.477/23, të datës 09.12.2023, ka lejuar përbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga faturat t'i paguaj shumën 1329.56€.

Kundër urdhrin përbarimor debitori ka paraqitur prapësim, me te cilin ka kundërshtuar Urdhrin për përbarim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, me aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përbarimit, të Përbaruesit Privat, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar së përbarimi është lejuar në baze te dokumentit te besueshëm, faturën te cilat janë pranuar ne mënyre te rregullt nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht te njëjtat paraqesin baze për lejimin e përbarimit ne kuptim nga neni 29 LPP. Andaj marrë parasysh këto gjykata e shkallës e pare ka vendosë si ne dispozitiv te aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përbaruesit privat, me të cilin është caktuar përbarimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përbarimi është lejuar në bazë të faturave origjinale të lëshuara nga kreditori, te cila fatura në mbështetje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe te njëjtat si te tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përbarimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj. Propozimi për përbarim i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë ne pajtim me nenin 37 të LPP-së e cila thotë se *“kur propozimi për përbarim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton qe propozimit ti bashkëngjitet dokumentit tillë ne origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”* çka edhe gjykata shkalles e dytë vlerëson se kreditori ka vepruar ne pajtim me këtë nen, nga te cilat fatura te besueshme është caktuar përbarimi.

Ndërsa lidhur me pretendimet e debitorit ne ankese se fatura nuk përmban afatin përmbushjes se detyrimit nga debitori, gjykata vlerëson se nuk ekzistojnë këto pretendime për arsye se, fatura si dokument përbarimor përmban afatin e përmbushje gjithashtu edhe Urdhëri përbarimor përmban aftin përmbushjes ne baze te nenit neni 27 parag 2 i te LPP parasheh *“Në qoftë se me*

anë të dokumentit përmbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit, afati i tillë do të caktohet me anë të aktvendimit për përbarimin, dhe urdhrit për përbarim, për shtatë (7) ditë” e qe ne rastin konkret urdhri për përbarim parasheh se detyrimit duhet të përmbushet brenda afatit prej 7 dite me te cilin është përshkruar se “ Urdhërohet Debitori qe ne afat prej 7 ditësh pas pranimit te këtij urdhri t’ia paguaj kreditorit borxhin ne lartësi prej 1329.56 € me kamat ligjore sipas LMD-së, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore” Andaj ne baze te dispozitave ligjoret te lartcekur dhe shkresave te lenden rezulton se urdhërim përbarimor i plotëson kushtet ligjor te LPP. Ndërsa lidhur me pretendimin tjera gjykata vlerëson se pretendimet e debitorit rezulton te jenë te pabazuara dhe te paargumentuara ashtu qe si te tilla mbesin vetëm ne natyrën deklarative dhe jo relevante për te vendosur ndryshe, nga del se nuk plotësohen as kushtet ligjore nga neni 71 i LPP.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe as ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Po ashtu vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm-faturën, të cilat kreditori ia ka bashkangjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përbarim, janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përbarimit të propozuar nga kreditori, ngase faturat e lartecekura, në bazë të së cilave është caktuar përbarimi, ligjërisht paraqesin bazë juridike për caktimin e përbarimit sepse te njëjtat janë pranuar nga debitori, prandaj gjykatë vlerëson se debitori ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme ne mbështetje te pretendimeve te tij konform nenit 69 par.5 te LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 te LPP, prandaj vendosi qe këto pretendime ti refuzoj si te pabazuara.

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkallës se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.981/24, me datë 24.06.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi